

Në bazë të neit 3.1-ë të Rregullores mbi Vetqeverisjen e Komunave të Kosovës nr. 2000/45 , nenit 39,40 dhe 52 të Ligjit mbi tokën ndërtimore (Gaz.zyr. e Kosovës nr.14/80) e aplikueshme sipas Rregullores nr. 1999/1, nenit 19 të Statutit të Komunës së Suharekës, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e vet të mbajtur me datën 06.12.2001 mori këtë:

V E N D I M
MBI DHËNIEN E TOKËS NDËRTIMORE NË SHFRYTËZIM TË PËRHERËSHËM

Neni 1

Ndahet në shfrytëzim të përhershëm dhe me kompenzim toka ndërtimore për ndërtimin e objektit banesor-afarist në parcelën kadastrale nr.2021 në sipërfaqe prej **0.23,61 ha**, e evidentuar sipas fletës poseduese nr. 409, pronë shoqërore e KK të Suharekës, ZK Suharekë.

Neni 2

Në bazë të këtij Vendimi dhënia e tokës ndërtimore do të bëhet përmes tenderit i cili do të jet publikë ku do të caktohen kriteret e konkurimit.

Neni 3

Tenderin për dhënie në shfrytëzim të tokës ndërtimore e shpallë dhe e zbaton Komisioni prej 5 anëtarëve të cilin e emëron Bordi i Drejtorëve.

Neni 4

Komisioni për zbatimin e tenderit përcakton numrin e ofertave të pranuar dhe konstaton se a janë paraqitur ofertat me kohë dhe complete.

Për punën e vet Komisioni mban procesverbal. Shqyrton ofertat dhe përpilon ranglistën e ofertuesëve të cilët i plotësojnë kushtet e parapara sipas tenderit dhe të njëjtat është i detyruar që t'i publikojë në tabelën e shpalljeve në afat prej 10 ditësh nga dita e përpilimit të saj. Pjesëmarrësit e tenderit kanë të drejtë kundërshtimi kundër konkluzionit të Komisionit, Bordit të Drejtorëve në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin të Konkluzionit.

Bordi i Drejtorëve nëse vëren ndonjë parregullsi që është në kundërshtim me konkursin, do ta anulojë Konkluzionin e Komisionit dhe do ta kthejë për rivendosje.

Neni 5

Pas kalimit të afatit për kundërshtim në Konkluzën e Komisionit dhe pas vendosjes sipas kundërshtimeve , Komisioni dërgon propozimin e arsyetuar për dhënie e tokës në shfrytëzim ose refuzimin e ofertave Bordit të Drejtorëve.

Neni 6

Në bazë të Konkluzës së Komisioni Bordi i Drejtorëve merr vendim për dhënien e tokës ndërtimore në shfrytëzim ndërmarrjeve të cilat kanë ofruar kushte më të mira në bazë të tenderit.

Vendimi është definitiv në procedurën administrative.

Neni 7

Në bazë të Vendimit mbi dhënien e tokës në shfrytëzim, shfrytëzuesi është i obliguar që të lidhë kontratë me Kuvendin e Komunës ku të përcaktohen të drejtat dhe detyrime reciproke.

Neni 8

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për mardhënie pronësore-juridike dhe Drejtoria për Urbanizëm, KK Suharekë.

Neni 9

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Suharekë.

KUVENDI I KOMUNËS

01. Nr. 264
Suharekë, më 10.12.2001

Kryetari
/ Ukë Bytyqi /